



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

DATË/A:	21/02/2023
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit Komuna Gjilan
CC:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zv.Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i shkresës nga Komuna e Gjilanit me numër të protokollit 753/23 të datës 14/02/2023 për dhënie të pëlqimit për Taksat e lejes ndërtimore

Të nderuar/a,

Bazuar në shkresën e datës 14/02/2023 me numër protokollit 753/23, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe taksës administrative për leje rrënimi nga Komuna e Gjilanit (tutje si: Komuna), MMPHI ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën së bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksat në pajtim me Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë e llogaritur nga Komuna është **1.50 €/m²** (një euro e pesëdhjetë centë për metër katror).

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të e llogaritur nga Komuna është **5.01 €/m²** (pesë euro e një cent për metër katror).

Taksa Administrative për leje rrënimi e llogaritur nga Komuna për kategorinë I dhe II është **0.90 €/m²** (zero euro e nëntëdhjetë centë për metër katror).

Tarifën për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 7 të UA Nr.02/2018 dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1